



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr. 409/15 prot.

Tepelenë, më 01 . 03 . 2021

VENDIM

Nr. 16 , datë 26.02.2021

PËR

“ PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN KËSHILLIT BASHKIAK NR. 74, DATË 28.12.2018 “PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TË BASHKISË TEPELENË PËR VITIN 2019”, TË NDRYSHUAR”

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjin nr.115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës”; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë për vitin 2019”, të ndryshuar; Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” të ndryshuar; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tepelenë,

VENDOSI:

4. Miratimin e propozimit të Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) Tepelenë, për disa ndryshime në Vendimin Këshillit Bashkiak nr. 74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë për vitin 2019”, të ndryshuar, sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Në "PASQYREN NR.3", pika B.3 "Për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 2 (dy) për qind të vlerës së investimit (Sipas vendimit të Këshillit Bashkiak për përcaktimin e zonave malore)", ky taksimi do të përcaktohet pasi të paraqiten të plota augmentet për nivelin e përqindjes së taksimit duke mos përcaktuar vetëm një përqindje taksimi fikse, por në funksion të largësisë apo vështirësisë së terrenit të thyer malor etj.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miraturar me 14 vota

Vota Pro 14


Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 01.03.2021

KRYETAR

ELVIS SHEHU



TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË (TNI)

PASOYRA NR. 3

NR.	EMËRTIMI I LLOJIT TË LEJES	PËRSHKRIMI I LLOJIT TË LEJES	TNI
1	- Ndërtim i ri; - Shtesë ndërtore apo vertikale;	Me funksion Banimi ose Bujqësor	4% e çmimit të shijes për metër katror të objektit të ri
2	- Pristyje ndërtimi ekzistues; - Pa ndryshim aktivitet apo funksioni; - Struktura me materiale të lehta e të çmontueshme; - Rezimim; - Rezervuar; - Cërrime toke	Me funksion Banimi ose Bujqësor	4% e vlerës së preventivit
3	Rikonstruksion me ndryshim funksioni	Nga funksion Banimi, në funksion Njësi Shërbimi, aktivite, akomodim etj.	6% e vlerës së preventivit
4	Ndërtesa të legalizuara	Nga funksion apo aktivitet Njësi Shërbimi, në funksion Banimi	4% e vlerës së preventivit
		Për objektet e legalizuara në Njësitë Administrative Tepelenë (qytet), taksa do të arketohet vetëm për objektet e legalizuara para datës 01.06.2018, si dhe për objektet që do të legalizohen pasi të hiqet pezullimi i zhvillimit, me miratimin e PPV-së të Bashkisë. Të gjitha objektet e legalizuara apo që legalizohen dhe që kanë arkëtuar ose jo TNI në periudhën 01 qershor 2018 deri në miratimin e PPV-së. Leja e Legalizimit konsiderohet/është nul dhe e pavlefshme.	0,5% e vlerës së investimit

Shënime:

Baza ligjore:

- A. - Ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, si dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

B.

1. Baza e takses është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shijes së ndërtimit për qëllime banimi apo të njëjste të tregimit dhe shërbimit. Çmimi i shijes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të njëjrtë me akt nga Këshilli i Ministrave.

2. Në rastin e ndërtimit për qëllime banimi, bujqësor apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4% dhe 6% e çmimit të shijes për metër katror (e specifikuar tek tabelat e mësipërme). Baza e takses është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shijes së njëjste të shërbimit apo ndërtimit për qëllime banimi apo bujqësore. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrato koncesionare, e cila preket banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit. Çmimi i shijes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Eni Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

3. Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë, të ndërtimit individual për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individët apo me sipërmarrje; si dhe të ndërtimit për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 2 (dy) për qind e vlerës së investimit. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroportëve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimit të reja është 0,1% e vlerës së investimit, por jo më pak se 100.000 lekë për hektar të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit. Për ndërtimet, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimit të reja është 0,5% e vlerës së investimit. AI

4. Detyrimi për pagesën e takses i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbahet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogan të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

5. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

6. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të njëjta me regjistrat dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

7. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

8. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtësive, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përcaktimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile.

9. Pagesa e TNI sipas tabelës së mësipërme (përveç pikës 4) kryhet e plotë pas miratimit të vendimit, por jo më vonë se 15 ditë kalendrike nga njoftimi nëpërmjet sistemit elektronik e-leje. Dokumenti i lejes i dorëzohet (elektronikisht dhe fizikisht) zhvilluesit pasi është kryer kjo pagesë.

10. Autoriteti vendor i planifikimit nuk e paguan takson e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për zhvillimet e veta me fonde publike.

C. Struktura e ngarkuar për llogaritjen, lëshimin e autorizimit dhe detyrimin për kryerjen e pagesës së takses së ndikimit në infrastrukturë është DPKZHT, pranë Bashkisë Tepelenë.

Gjithashtu është përgjegjasi edhe e Zyrës së Tanim Taksave të Bashkisë Tepelenë, për regjistrimin debitor dhe detyrimin e zhvilluesit/subjektit për kryerjen e pagesës së TNI.

PËR DPKZHT:

Inxh. Lorenc Bani

TARIFAT E SHËRBIMIT TË DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT (DPKZHT)
PËR VITIN 2021

PASQYRA NR. 1

NR.	EMËRTIMI I SHËRBIMIT ONLINE	PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT ONLINE	NJËSIA	VLERA E TARIFËS
1	Shqyrtim kërkesë për pajisje me "Leje Zhvillimi"	-Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion banimi ose bujqësor -Llogaritet për të gjithë sipërfaqen e pronës që zhvillohet -Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion shërbimi ose bujqësor -Llogaritet për të gjithë sipërfaqen e pronës që zhvillohet	Lekë/m ²	15
2	Shqyrtim kërkesë për pajisje me "Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ² "	Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion shërbimi	Lekë	10'000
3	Shqyrtim kërkesë për pajisje me "Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe mbi 250 m ² "	Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion shërbimi	Lekë	15'000
4	Shqyrtim kërkesë për pajisje me "Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m ² "	Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion shërbimi	Lekë	20'000
5	Shqyrtim kërkesë për pajisje me "Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe mbi 250 m ² "	Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion shërbimi	Lekë	25'000
6	Shqyrtim kërkesë për pajisje me "Leje ndërtimi në infrastrukturë"	Për çdo aplikim apo riaplikim në funksion të banimit ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim në funksion të shërbimit	Lekë	15'000
7	Shqyrtim kërkesë për "Ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit"	Të gjitha llojet e lejeve, aplikim apo riaplikim, me funksion banimi ose bujqësor Të gjitha llojet e lejeve, aplikim apo riaplikim, me funksion shërbimi	Lekë	25'000
8	Shqyrtim i kërkesës për "Deklaratë paraprake për kryerje punimesh"	Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion shërbimi	Lekë	30'000
9	Shqyrtim kërkesë për "Ndryshimin e aktiviteteve apo funksioneve të objektit"	Nga Banesë në Njësi shërbimi Nga Njësi shërbimi në Banesë	Lekë	50'000 + Diferencën e TNI (2% e çmimit të shitjes)
10	Shqyrtim kërkesë për "Rikonstrukcion me ndryshim funksioni"	Nga Banesë në Njësi shërbimi Nga Njësi shërbimi në Banesë	Lekë	100'000 + Diferencën e TNI (2% e çmimit të shitjes)
11	Shqyrtim kërkesë për "Rikonstrukcion pa ndryshim funksioni"	Nga Banesë në Njësi shërbimi Nga Njësi shërbimi në Banesë	Lekë	100'000
12	Shqyrtim kërkesë për "Prishje të ndërtimit ekzistues"	Me funksion banimi ose bujqësor Me funksion shërbimi	Lekë	20'000
13	Shqyrtim kërkesë të "Njoftimit për fillimin e punimeve"	Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion shërbimi	Lekë	30'000
14	Shqyrtim kërkesë të "Njoftimit për raportin e mbikëqyrjes"	Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion shërbimi	Lekë	10'000
15	Shqyrtim kërkesë të "Njoftimit për raportin e kolaudimit"	Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion shërbimi	Lekë	20'000
16	Shqyrtim kërkesë për pajisje me "Certifikatë përdorimi"	Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion shërbimi	Lekë	10'000
17	Pajisja me "Certifikatë përdorimi"	Me funksion banimi ose bujqësor Me funksion shërbimi	Lekë	15% e TNI-së 20% e TNI-së
18	Shqyrtim kërkesë për "Shtyrje afati të lejes së ndërtimit"	Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion shërbimi	Lekë	20'000
19	Shqyrtim kërkesë për "Ndryshim të subjektit zbatues ose zhvillues"	Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion shërbimi	Lekë	30'000
20	Shqyrtim i kërkesës me "Procedurë të përshpejtuar", kur nuk parashikohet ndryshe	Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion banimi ose bujqësor Për çdo aplikim apo riaplikim, me funksion shërbimi	Lekë	10'000 20'000
21	Shqyrtim i kërkesës për pajisje me: "Leje zhvillimi në rastet e fatkeqësisë natyrore" "Leje për ndërtim të reja në zonat e dëmtuara dhe në zonat e reja për zhvillim" "Leje rindërtimi, rikonstrukcioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar, me shtim apo ndryshim vëllimi" "Leje rindërtimi, rikonstrukcioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim vëllimi" "Leje për prishjen e ndërtimeve të dëtuara nga fatkeqësitë natyrore" "Leje ndërtimi apo rikonstrukcioni të infrastrukturës publike apo kritike në zonat e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore dhe në zonat e reja për zhvillim"	Për çdo aplikim apo riaplikim me funksion banimi apo shërbimi	Lekë	10 fishi i tarifës së shqyrtimit të zakonshëm të pasqyruar në këtë tabelë
22	Shqyrtim i kërkesës për pajisje me "Leje të të gjitha llojeve" me zhvillues Bashkinë Tepelenë	Për çdo aplikim apo riaplikim	Lekë	0

Shqyrtim kërkesë për pajisje me "AUTORIZIM për kryerje punime ndërtimi" për të cilat nuk është e nevojshme aplikimi online nëpërmjet sistemit elektronik e-leave. 1 Aplikohet vetëm për objekte që kanë dokument pronësie të regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Drejtoria Vendore Tepelenë ose me Leje Legalizimi të vlefshme dhe të regjistruar/lëshuar nga ALUIZNI apo ASHK.	Punime të cilat nuk kërkojnë pajisje me Leje Ndërtimi apo Deklaratë paraprake për kryerje punimesh si: -rifreskimi i lmyerjes, suvatimit dhe veshjes së fasadave me materiale që kanë karakteristika dhe ngjyra të njëjta me ato ekzistuese; -pastrimi i fasadave; -riparimi dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve, qepeneve dhe vitrinave (duke përfshirë përdorimin e materialeve të ndryshme), pa ndryshuar karakteristikat e tilla si, forma, ngjyra, dizajni dhe dimensionet e pjesëve të hapura dhe transparente; -zëvendësimi i pjeshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes; -riparimi dhe zëvendësimi i ullqeve e oxhakëve, edhe me materiale të ndryshme; -riparimi i ballkoneve, terracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse; -vendosja e hekurave mbrojtës në dritare; -vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave; -sistemimi i oborreve; -riparimi i rrethimeve ekzistuese. ii) ndërrhyrje të brendshme: - riparimi dhe rinovimi i dysheve; - riparimi dhe restaurimi i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave; - riparimi dhe rinovimi i dyerve dhe dritareve, përfshirë vendosjen e xhamave. iii) ndërrhyrje në impiante higjieno-sanitare: - veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit; b) Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara; c) Lëvizjet e dheut që lidhen, në mënyrë të posaçme, me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore ose blegtorale, përfshirë ndërrhyrjet në impiante hidraulike bujqësore.	Lekë 3'000 objekte apo infrastrukturë funktson banimi 10'000 objekte apo infrastrukturë 10'000 funksion shërbimi
--	---	---

PASQYRA NR. 3

NR.	EMËRTIMI I SHËRBIMIT	PËRSHKRIMI	NJËSIA	VLERA E TARIFËS
1	Tërheqje fizike e dokumenteve nga arkivi i drejtorisë (të njësuara me dokumentet e dosjes së arkivit)	Dokumente format letre A4 Dokumente format letre A3 Formulari i Lejes së: Sheshit; Ndërtimit; Zhvillimore; Shfrytëzimi; Përdorimi; Certifikatë Përdorimi	Lekë/Fleta Lekë/Fleta Lekë/Fleta	500 1'000 1'500
2	Tarifat për dhënien e informacionit dhe/ose vënien në dispozicion të dokumenteve fizike, me mbi 5 fletë, përveç atyre të përmendura më lart. (kostoja e riprodhimit të informacionit dhe/ose dokumentacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, edhe e dërgimit të tij me postë etj).	E gjithë dosja (përveç atyre dokumenteve që mbrohen me ligj) Fotokopje bardhe e zi, format letre A4 Printime bardhe e zi, format letre A4 Fotokopje me ngjyra, format letre A4 Printime me ngjyra, format letre A4 Fotokopje bardhe e zi, format letre A3 Printime bardhe e zi, format letre A3 Fotokopje me ngjyra, format letre A3 Printime me ngjyra, format letre A3 Skanimë format letre A4 Skanimë format letre A3 CD DVD Shërbimi postar	Lekë Lekë/Fleta Lekë/Fleta Lekë/Fleta Lekë/Fleta Lekë/Fleta Lekë/Fleta Lekë/Fleta Lekë/Fleta Lekë/Fleta Lekë/Fleta Lekë/copa Lekë/copa Lekë	25'000 10 15 20 30 20 50 150 200 20 35 100 200 250

Shënime:

- Objekte banim konsiderohen objektet që me funksion banimi pra në të cilat qëndrojnë/jetojnë familjet por që nuk ka aktivitet shërbimi/tregetare për përfitime të çdo natyre.
- Objekte shërbimi konsiderohen objektet me funksion tregtar, Njësi Shërbimi (përfshirë garazhe, kabina elektrike) të përkohshme/përhershme për përfitime të çdo natyre, ose institucione publike e jo publike.
- Baza ligjore: Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave" i ndryshuar; si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre.
- Kërkesa apo aplikimi për leje ndërtimi, rikonstruksioni, deklarate paraprake për kryerje punimesh, ndryshim funksioni, njoftim për fillim punimesh, etj., për të gjitha objektet/investimet private apo publike, të paraqitura në pasqyrën nr. 1, mund të kryhet nga aplikanti/kërkuesi vetëm nëpërmjet sistemit elektronik (online) në portalin "e-Albania", rubrika "e-leave". Asnjë dokument apo dosje e dorëzuar fizikisht apo e ardhur me postë në Bashkinë Tepelenë, për t'u pajisur me leje, nuk është ligjore dhe nuk do të shqyrtohet.
- Tarifat për shqyrtimin e kërkesave/aplikimeve në sistemin elektronik paguhen vetëm nëpërmjet bankave të nivelit të dytë përjashtimisht rastit të Autorizimit për kryerje punimesh. Vërtetimi i kryerjes së pagesës duhet të dorëzohet elektronikisht, përmes llogarisë së aplikantit në portalin e-Albania. Në rast mosrespektimi të afatit të sipërpërmendur, kërkesa/aplikimi refuzohet.
- Për riprodhimin e dokumenteve të tjerë që nuk përfshihen në tabelën e mësipërme, shërbimi do të ofrohet sipas tarifave mesatare të shërbimit privat.
- Struktura e ngarkuar për llogaritjen, lëshimin e autorizimit dhe detyrimin për kryerjen e pagesës së taksës në ndikimit në infrastrukturë është DPKZHT, pranë Bashkisë Tepelenë. Gjithashtu është përgjegjësi edhe e Zyrës së Tatim Taksave të Bashkisë Tepelenë, për regjistrimin debitor dhe detyrimin e zhvilluesit/subjektit për kryerjen e pagesave sipas autorizimeve të lëshuar nga DPKZHT.

PËR DPKZHT:
Inxh. Lorenc Bami



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr. _____ prot.

Tepelenë, më ____ . ____ . 2021

P / VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2021

PËR

‘PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMINE KËSHILLIT BASHKIAK NR. 74, DATË 28.12.2018 “PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TË BASHKISË TEPELENË PËR VITIN 2019”, TË NDRYSHUAR’

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjin nr.115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; Ligjin nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Vendimine Këshillit të Ministrave nr.6, datë 06.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës”; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, të ndryshuar; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë për vitin 2019”, të ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; Vendimine Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar; Vendimine Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” të ndryshuar; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tepelenë,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit të Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) Tepelenë, për disa ndryshime në Vendimine Këshillit Bashkiak nr. 74, datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë për vitin 2019”, të ndryshuar, sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij vendimi.

Në "PASQYREN NR.3", pika B.3 "Për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 2 (dy) për qind të vlerës së investimit (Sipas vendimit të Këshillit Bashkiak për përcaktimin e zonave malore)", ky taksimi do të përcaktohet pasi të paraqiten të plota augmentet për nivelin e përqindjessë taksimit duke mos përcaktuar vetëm një përqindje taksimi fikse, por në funksion të largësisë apo vështirësisë së terrenit të thyer malor etj.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elvis Shehu

JURIST

~~Julinda Karteri~~

